

Oman äidinkielen merkitys toisen kielen oppimisessa

albania

## **Rëndësia e gjuhës amëtare dhe të mësuarit e gjuhës tjetër**

### **Përse të mësuarit e gjuhës amëtare është me rëndësi ?**

Është me rëndësi, që fëmiju ta mësojë gjuhën amëtare mirë, sepse gjuha amëtare është bazë e të menduarit të fëmijut. Gjuha amëtare është me rëndësi edhe për faktin, se i ndihmon që ta mësojë gjuhën e re dhe ti përfitojë nohuritë e reja.

### **A mundet fëmiju ti mësojë mire dy apo më tepër gjuhë?**

Fëmiju mundë ti mësojë dy apo më tepër gjuhë shkelqyeshëm, nëse ati i ofrohet mundësia.

### **Në cilën gjuhë prindërit duhet tu flasin fëmijëve?**

Prindërit duhet tu flasin fëmijëve gjithnjë në gjuhën amëtare. Nëse prindërit flasin gjuhë të ndryshme në mes veti, atëherë secili duhet ti flasë fëmijut në gjuhën amëtare.

### **A e mëson fëmiju gjuhën finlandeze, nëse prindërit flasin me të në gjuhën amëtare?**

Fëmiju e mëson gjuhën finlandeze në qerdhe, në fazën parashkollore, në shkollë dhe në shoqëri. Nëse fëmiju e mëson mirë gjuhën amëtare, ai do ta mësojë më lehtë edhe gjuhën finlandeze, sepse ai e ka krijuar bazamentin e gjuhës.

### **Si munden prindërit ti ndihmojnë fëmijut për ta zhvilluar gjuhën amëtare?**

Të mësuarit dhe zhvillimi i gjuhës amëtare vie në pahë atëherë, nëse prindërit u flasin gjithnjë fëmijëve në gjuhën amëtare. Për këtë arsye fëmijët duhet të marrin pjesë gjithnjë në të mësuarit e gjuhës amëtare. Shtëpia luan rolin e rëndësishëm në aspektin e lartpërmendur.

### **A duhet fëmiju të marr pjesë në mësimin e gjuhës amëtare?**

Në të mësuarit e gjuhës amëtare fëmiju duhet të marr pjesë gjithnjë për shumë arsye: Gjuha amëtare i ndihmon fëmijut, që ti sjellë mendimet dhe shkathtësitë si dhe personalitetin e vet. Gjuha amëtare ndikon në zvoglimin e paraqitjes së vështërsive në mësim si dhe ndihmon në arritjen e rezultateve.

### **Si munden prindërit që tu ndihmojnë fëmijëve për ta mësuar gjuhën finlandeze?**

Gjuha tjetër mësohet më lehtë, nëse fëmiju e ka përvetësuar mirë gjuhën amëtare. Gjuha finlandeze mësohet më lehtë, nëse në shtëpi gjithnjë flasim në gjuhën amëtare. Në shkollë fëmiju e mëson gjuhën finlandeze duke qenë pjesëmarrës në të mësuarit e gjuhës së dytë finlandeze ( S2), aq gjatë përderisa fëmiju ta mësojë gjuhën finlandeze.

Ministria e arsimit

<http://mai.moped.fi>